

Kuvendi Komunal i Malishevës



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPSTINA OPSTINE MALISEVO



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 21/12/2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01/2115

PLANI VJETOR

për

Njësine e Auditimit të Brendshëm

në Komunën e Malishevës

për vitin 2023

Përgatitur nga NjAB:
Esat Gashi

Miratuar nga kryetari komunës
Z. Ekrem Kastrati



Malishevë
Dhjetor, 2022

I. HYRJE

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për vitin 2023 që miratohet nga Kryetari i Komunës. Në plan janë përfshirë fushëveprimi, objektivat, kohëzgjatja dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Detyrat e auditimit për vitin 2023 janë ndarë në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në NjAB.

Bazuar në Ligjin Nr.06/L -021 Për kontrollin e brendshëm të financave publike, kapitulli i III, auditimi i brendshëm, Ligjin mbi menaxhimin me financa Publike dhe përgjegjësit Nr.03/L-048, Udhëzimet Administrative, Instruksionet financiare në fuqi, Udhëzimi Evropian mbi Kontrollën-INTOSA-it, si dhe nevojën e Komunës për kryerjen e auditimit të brendshëm për vitin kalendarik 2023, NjAB do ta bëjë auditimin e brendshëm të bazuar në standardet ndërkombëtare më të përparuara sipas planit dhe dinamikës së paraparë.

Plani Vjetor do të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në organizatë apo në mesin e anëtarëve të NjAB-së, dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës.

II. AKTIVITETET E NJAB-së PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vitin 2023, NjAB e planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve në vijim, për arritjen e objektivave të përshkruar në Planin Strategjik:

Nr	Objektivat kryesore për vitin 2023	Aktivitetet për përmbushjen e objektivave	Detyrat
1	Aktivitetet e komunës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi për arritjen e objektivave.	Sigurimi i menaxhmentit të lartë të Komunës se aktivitetet janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Sigurimi dhe njohja e të gjitha ligjeve në fuqi.
2	Sigurimi i zbatimit të Ligjit Nr.06/L -021 Për kontrollin e brendshëm të financave publike, kapitulli i III, auditimi i brendshëm.	Sigurimin e menaxhmentit për rëndësinë e këtij ligji dhe roli i zbatimit të tij në tërësi në Komunë.	Mbajtja e takimeve me menaxhmentin e lartë të Komunës dhe implementimi i këtij ligji
3	Vlerësimi i mjedisit të kontrollit dhe ndarja e drejt e detyrave dhe përgjegjësi.	Sigurimi i menaxhmentit për vlerësimin e drejt të mjedisit dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.	Prezentimi i vlerimit menaxhmentit të lartë.
4	Funksionimi i sistemit të kontrollave të brendshme në të gjitha nivelet e Komunës dhe përmirësimi i tyre në vazhdimësi në bazë të nevojave të reja.	Funksionalizimi i sistemit të kontrollave të brendshme ekzistuese dhe sajimi i kontrollave të reja sipas nevojës.	Analiza e kontrollave të brendshme ekzistuese me qëllim të funksionimit më të mirë të tyre , dhënia e propozimeve për kontrollat të reja .

5	Menaxhimi dhe analiza e rrezikut dhe vlerësimi i tij nga menaxhmenti i Komunës.	Sigurimi i menaxhmentit për rëndësinë e analizimit dhe menaxhimit të rrezikut në të gjitha nivelet.	Vlerësimi i shkallës së rrezikut sipas rëndësisë dhe analiza e kësaj shkalë.
6	Auditimi i sistemeve me rrezikshmëri të lartë, të mesëm dhe të ultë në Komunë.	Sigurimi i menaxhmentit të lartë se i gjithë aktiviteti i këtyre sistemeve është përfshirë dhe ka për qëllim arritjen e objektivave të Komunës.	Auditimet e rregullta sipas planit vjetor.
7	Trajnimet e vazhdueshme të auditorëve në vazhdimësi në ngritjen profesionale me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës në Komunë.	Pjesëmarrja në trajnime. Furnizimi me literaturë. Aktivitete të tjera.	Marrja pjesë në trajnime të organizuara nga NJQHAB dhe ngritje profesionale të auditëve.
8	Rritja e numrit të auditëve në Komunë në bazë të nevojave për arritjen e objektivave të auditimit të brendshëm.	Plotësimi i vendeve të nevojshme për auditë në bazë të detyrave të planifikuara në planin strategjik.	Analiza e mundësive buxhetore për angazhimin e auditëve në Komunë.
9	Përmbushja në tërësi e planit vjetor të auditimit nga NJAB i cili është i bazuar në planin strategjik të auditimit.	Hartimi i drejtë i planit vjetor dhe programeve operacionale të NJAB-së.	Respektimi i planit vjetor në tërësi dhe programeve operacionale gjatë auditimit të brendshëm

III. DETYRAT E AUDITIMIT

3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar

NjAB, nuk ka ndonjë detyrë të pa zbatuar nga viti i kaluar.

Detyrat e mëposhtme janë përfshirë në planin e tanishëm:

Indeksi i rrezikut	Lloji i detyrave të auditimit	Njësia strukturale	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha
I mesëm	AAS-23-01	Teknologjia Informative	Funksionimi sistemit të kontrollit të brendshëm	Vlerësimi i sistemit të KB, aktivitetet që kanë të bëjnë me Teknologjinë Informative	Janar-Shkurt
I lartë	AAS-23-02	Drejtoria e Kuvendit Komunal	Shpenzimet e komunalive	Vlerësimi i sistemit të KB, aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e shpenzimeve, raportimet	Mars-Prill
I lartë	AAS-23-03	Drejtoria për buxhet dhe financa	Vendosja e sistemit të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e pasurisë së komunës.	Pasuria e komunës, nxjerrja e vendimeve për vlerësim të pasurisë si dhe e vendimeve për inventarizim dhe mbikqyrja e këtyre proceseve.	Maj

I mesëm	AAS-23-04	Drejtoria e Gjeodezisë	Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	Vlerësimi i sistemit të KB, aktiviteteve të drejtorisë, raportimet	Qershor
I mesëm	AAS-23-05	Drejtoria e Arsimit	Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	Vlerësimi i sistemit të KB, aktiviteteve të drejtorisë	Korrik
I mesëm	AAS-23-06	Drejtoria e Kulturës	Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	Vlerësimi i sistemit të KB, aktiviteteve të drejtorisë	Shtator
I lartë	AAS-23-07	Drejtoria për buxhet dhe financa	Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	Vlerësimi i sistemit të KB, aktiviteteve të drejtorisë	Tetor
I lartë	AAS-23-08	Zyra e prokurimit	Vlerësimi i sistemit të KB analiza e shkallës së rrezikut, planifikimi i prokurimeve për vitin 2023, realizimi i prokurimeve deri në përfundim të raportues	Vlerësimi i sistemit të KB-së, aktiviteteve të zyrës së prokurimit	Nëntor
I lartë	AAS-23-09	Sipas kërkesës së menaxhmentit	Kërkësat e menaxhmentit për ndonjë çështje	Aktivitete të ndryshme	Dhjetor

3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që janë duke u zhvilluar

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	Planifikuar për vitin	Detyra e auditimit nr.
A.	B.	C.	D.	E.	F.
1.	Teknologjia Informative	1.71	I mesëm	2023	AAS -23-01
2.	Drejtoria e Kuvendit Komunal	2.30	I lartë	2023	AAS -23-02
3.	Drejtoria për buxhet dhe financa	2.50	I lartë	2023	AAS-23-03
4.	Drejtoria e Gjeodezisë	2.15	I mesëm	2023	AAS-23-04
5.	Drejtoria e Arsimit	2.15	I mesëm	2023	AAS-23-05
6.	Drejtoria e Kulturës	2.15	I mesëm	2023	AAS-23-06
7.	Drejtoria për buxhet dhe financa,	2.50	I lartë	2023	AAS-23-07
8.	Zyra e prokurimit	2.50	I lartë	2023	AAS-23-08
9.	Sipas kërkesës së menaxhmentit	2.50	I lartë	2023	AAS-23-09

Detyrat e auditimit

Detyrat e auditimit për vitin 2023 janë në përputhje me detyrat e aprovuara në planin strategjik. Lidhja ndërmjet detyrave të planifikuara në planin strategjik dhe planit vjetor tregohet në tabelë, si më poshtë:

Llojet e detyrave të auditimit	Numri i detyrave për vitin	Numri i përgjithshëm i ditëve	Detyrat e auditimit sipas planit strategjik	Implementimi i planit në përqindje
Detyrat për shërbimet e sigurisë	9	654	9	100 %
<i>Rrezik i lartë</i>	5	300	5	100 %
<i>Rrezik i mesëm</i>	4	183	4	100 %
<i>Rrezik i ulët</i>	0	0	0	0
Ndjekja e rekomandimeve	9	25	9	100 %
Detyrat për shërbime këshillimi	9	32	9	100 %

Lloji i detyrave të auditimit dhe totali i ditëve

3.3 Ndarja e detyrave të auditimit

Koha efektive e punës (KEP)

Programi kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja e punonjësve të NJAB-së në detyrat e auditimit për 2023:

Auditori	Totali i ditëve të punës	Pushimet vjetore	Pushimet mjekësore	KEP	Trajnimet	Punë admin.	Planifikimi strategjik dhe vjetor	Monitorimi periodik dhe sigurimi i cilësisë	Auditimet e mëhershme	Shërbimet këshilluese	Auditimet
Udhëheqësi i NJAB-së	248	25	5	218	15	15	22	22	15	22	107
Auditori 1	248	25	5	218	15	5	0	0	5	5	188
Auditori 2	248	25	5	218	15	5	0	0	5	5	188
Totali:	744	75	15	654	45	25	22	22	25	32	483

Koha e punës efektive

Tremujori	Nr.	Detyrat e auditimit	Prioriteti i njësisë së synuar	Person-ditë	Udhëheqësi i ekipit	Anëtarët e ekipit	Anëtarët e ekipit
TM1		AAS-23-01	Rrezik i mesëm	46	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		AAS-23-02	Rrezik i lartë	60	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
TM2		AAS-23-03	Rrezik i lartë	60	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		AAS-23-04	Rrezik i mesëm	46	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
TM3		AAS-23-05	Rrezik i mesëm	46	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		AAS-23-06	Rrezik i mesëm	45	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
TM4		AAS-23-07	Rrezik i lartë	60	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		AAS-23-08	Rrezik i lartë	60	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		AAS-23-09	Rrezik i lartë	60	Auditori 1	Auditori 2	Auditori 3
		Totali:	483 ditë për detyra të auditimit				

Programi kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja për auditorët e brendshëm